

VENDIM
Nr.1646, datë 24.12.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE
NË KOMUNËN XHAFZOTAJ, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave në komunën Xhafzotaj, Durrës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës Xhafzotaj. Regjistrimi i ri i pasurisë, 2000 (dy mijë) m², tokë/arë, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2000 (dy mijë) m², tokë/arë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna Xhafzotaj.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, të përballohet nga të ardhurat e komunës Xhafzotaj, planifikuar në buxhetin e vitit 2008.
6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të vendimit.
7. Afati i përfundimit të punimeve në objektin “Zgjerimi i varrezave publike të komunës” të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna Xhafzotaj, për realizimin e këtij projekti.
8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Xhafzotaj për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË
DO TË SHËPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, NË
KOMUNËN XHAFZOTAJ**

Nr.	Emër,mbiemër	Sipërfaqja në m ²	Çmimi në lekë	Vlera	Lloji i dokumentit	Zona kadastrale	Nr.pasurisë
1	Fiqeri Bregu	400	1250	500 000	cert.pronësie	3852	110/1
2	Rahman Neziri	680	1250	850 000	cert.pronësie	3852	110/35
3	Gani Nerjaku	729	1250	911 250	cert.pronësie	3852	110/33
4	Gani Nerjaku	191	1250	238 750	cert.pronësie	3852	110/31
	Shuma në total	2000	1250	2 500 000			